

**VENDIM**  
**Nr. 789, datë 14.11.2012**

**PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË AMENDIMIT NUMËR DY TË MARRËVESHJES SË  
NDIHMËS NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE  
QEVERISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS, PËR QEVERISJEN ME DREJTËSI  
E NË MËNYRË DEMOKRATIKE DHE PËR INVESTIMIN NË NJERËZ E RITJEN EKONOMIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Miratimin e dokumentit të amendimit numër dy të marrëveshjes së ndihmës, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për qeverisjen me drejtësi e në mënyrë demokratike dhe për investimin në njerëz e ritjen ekonomike, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**